



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE SHERBIMEVE SOCIALE

Nr. 13355 Prot.

Fier më 21/11/2025

Projekt-Vendim

NR. 1061 dt. 21/11/2025

Për zëvendësimin e një anëtarit të Komisionit të Strehimit të Bashkisë Fier, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.143, datë 23.12.2024 "Për miratimin e Komisionit të Strehimit", i ndryshuar.

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt. ____/____/2025, i paraqitet për shqyrtim, materiali nga ekzekutivi i Bashkisë Fier, për zëvendësimin e dy anëtarëve të komisionit të strehimit, marrë shkas nga ndryshimet e ndodhura, lind nevoja e rishikimit të përbërjes së këtij komisioni, me qëllim funksionimin e Komisionit të Strehimit, në kuadër të programeve të strehimit social.

Në zbatim të nenit 8, pikat 1 e 2, dhe nenit 9, pika 1.1, germa 'b', të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të Ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" (i ndryshuar), si dhe të VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social, të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKB nr. 143, datë 23.12.2024, "Për miratimin e Komisionit të Strehimit", i ndryshuar.

Propozon:

1. Anëtarja e komisionit znj. Merita Bitri ka dalë në pension, ndaj del e domosdoshme zëvendësimi i saj. Për këtë pozicion propozojmë **znj. Denisa Azizaj**, me detyrë Juriste pranë Bashkisë Fier.
2. Struktura e Bashkisë Fier ka ndryshuar me VKB nr. 87 datë 25.09.2025 dhe Sektori i Strehimit ka kaluar nga Drejtoria Juridike në varësi të Drejtorisë së Politikave dhe Shërbimeve Sociale. Për rrjedhojë, anëtarja e komisionit, **znj. Denisa Azizaj**, duhet të zëvendësohet nga **znj. Natasha Sollaku**, specialiste pranë Drejtorisë së Politikave dhe Shërbimeve Sociale, Bashkia Fier.
3. Sa më sipër, ju paraqesim për miratim projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 143, datë 23.12.2024, 'Për miratimin e Komisionit të Strehimit'".
4. Bashkia Fier, nëpërmjet Komisionit të Strehimit dhe Këshillit të Bashkisë, do të zbatojë procedurat për programet sociale të strehimit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ky proces bazohet në Ligjin Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
5. Pikat e tjera të këtij vendimi mbeten të pandryshuara

6. Ngarkohet për zbatimin e mëtejshëm të procedurave administrative-ligjore ekzekutivi i Bashkisë Fier.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

KRYETAR
Armando Subashi

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ZV.KRYETARE E BASHKISË

MIRELA PITUSHI

